RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Komunikatë

Bordi miratoi skemën programore të RTK-së

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës në mbledhjen e sotme ka miratuar skemën e re programore. Skema e re programore krahas programit të rregullt, përmban edhe emisione të reja që mbulojnë interesat dhe shijet e shikuesve të televizionit dhe dëgjuesve të radios.

Pasurimi i skemës së re me programe edukative, argëtuese, seriale televizive dhe tema të tjera me interes për audiencën e RTK-së siç janë mjekësia, arti, sporti, teknologjia janë ato për çfarë jemi angazhuar vetëm e vetëm që mediumi publik të jetë adresa kryesore e publikut.

Gjithashtu me skemën e re do të ketë edhe emisione të radios që do të transmetohen në televizion dhe anasjelltas.

Përveç kësaj në RTK së shpejti do të nisë edhe bashkëpunimi më i ri më Zërin e Amerikës, ku shikuesit e RTK-së kanë mundësinë të informohen për zhvillimet e fundit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në këtë mbledhje u shqyrtua dhe miratua raporti i shpenzimeve për periudhën raportuese korrik - shtator 2023.